

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIV, nr. 7803  
E hënë, 3 qershor 2024  
Çmimi 0.50

Çitaku: S'kemi shtiza për kolegët në opozitë, jemi në garë me LV-në | FAQE 6



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## KURTI PRITET TA PËRFUNDOJË NË TËRËSI MANDATIN, SKEPTICIZËM PËR ZGJEDHJE NË VJESHTE | FAQE 4-5




Analistët politikë kanë theksuar se Qeveria e Kosovës pritet të përfundojë në tërësi mandatin deri në shkurt të vitit 2025 pas

dështimit për të arritur një konsensus me partitë opozitare për shpërndarje të Kuvendit. Megjithëse kryeministri Albin

Kurti ka shprehur pëlqimin që zgjedhjet të mbahen në vjeshtë, kjo po shihet e pamundur nga analistët politikë

**MPJD-ja E QUAN ARBITRAR ARRESTIMIN E SHTETASIT KOSOVAR NGA SERBIA** F. 3



**RRYMA PËR VERIUN: S'KA KOMPENSIM PËR MILIONAT E SHPENZUARA DERI MË 2012** F. 7



### AKTUALE



**SCHOLZ: DO TA MBROJMË ÇDO CENTIMETËR KATROR TË TERRITORIT TË NATO-S** F. 2

**AMBASADORI ITALIAN NË SERBI THOTË SE FORMIMI I ASOCIACIONIT ËSHTË KUSHT PËR PRANIMIN E KOSOVËS NË KIE** F. 3

**GASHI THOTË SE KURTI IU PËRGJIGJ FTESËS SË MADHE TË SHOQIPTARËVE OPOZITARË PËR NJË RROTACION POLITIK NË MAQEDONI** F. 5

### EKONOMI



**GËRXHALIU: SUPERPUNA, ZHËNËJIM DHE DEMOTIVIM PËR TË RINJTË KOSOVARË**

Safet GËRXHALIU

**DOGANA DHE POLICIA SEKUESTROJNË 33 KILOGRAMË ARI** F. 7

### SPORT



**VOJVODA E BEKAJ PRESIN PARAQITJE TË MIRË NË OSLO** F. 10

**RENOVA**  
Maqedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
PUTZ  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mobi: +377 44 501289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA** GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Scholz: Do ta mbrojmë çdo centimetër katror të territorit të NATO-s

BERLIN, 2 QERSHOR - Vendimi i NATO-s së voni për ta përforcuar kufirin e vet lindor ka për qëllim ta frenojë Rusinë, tha të dielën kancelari gjerman Olaf Scholz. Ai tha se Moska duhet ta ketë të qartë se aleanca ushtarake do të jetë e gatshme për ta mbrojtur veten nëse është e nevojshme.

Duke folur në Forumin Ekonomik Gjerman, ku mori pjesë edhe kryeministrja e Lituanisë, Ingrida Simonyte, Scholz tha se Gjermania ka luajtur rol udhëheqës në praninë e NATO-s në vendet e baltikut në kufi me Rusinë tash

e një dekadë. “Për shkak se kërcënimi nga Rusia do të vazhdojë, ne dhe aleatët e tjerë vendosëm vitin e kaluar të zhvendosim njësitë shtesë në vendet baltike, si dhe për ta vendosur atje përherë një brigadë të tërë në të ardhmen”, tha Scholz. “Por ky ndryshim në politikën e sigurisë është i nevojshëm për t’i treguar Rusisë: Ne jemi të gatshëm për ta mbrojtur çdo centimetër katror të territorit të NATO-s kundër sulmeve”, shtoi ai.

Ai theksoi se diplomacia do të jetë e suksesshme vetëm nga pozicioni i forcës.



Në fillim të kësaj jave presidenti i Rusisë, Vladimir Putin, i paralajmëroi vendet anëtare të NATO-s të mos e lejonin Ukrainën të kryejë sulme me armët e tyre brenda Rusisë, pasi disa vende aleate të Perëndimit vendosin t’i heqin kufizimet ndaj Kievit për përdorimin e armëve me të cilat e furnizojnë. Shefi i NATO-s, Jens Stoltenberg, i hodhi poshtë paralajmërimet e Putinit të premten, duke thënë se aleanca ka dëgjuar shumë herë paralajmërimet të tilla në të kaluarën dhe se vetëmbrojtja nuk nënkupton përshkallëzim.

## Zelensky thotë se 100 vende do të marrin pjesë në samitin për paqe në Zvicër



KIEV, 2 QERSHOR - Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, u takua me liderët e jashtëm në Singapor të dielën, në prag të samitit vjetor të sigurisë Shangri-La Dialogue, ku kërkoi mbështetje ndërkombëtare para konferencës për paqe që do të mbahet në Zvicër këtë muaj.

Zelensky tha se më shumë se 100 vende dhe organizata janë zotuar se do të marrin pjesë në takimin për paqe në Zvicër më 15-16 qershor.

Rusia nuk ka marrë pjesë në ngjarjen e Singaporit prej se e nisi pushtimin e plotë të Ukrainës më 2022, ndërsa Kina ka thënë se nuk do të marrë pjesë.

Zelensky dhe ministri i Mbrojtjes i Ukrainës, Rustem Umerov, u takuan në Singapor për më shumë se një orë me sekretarin

amerikan të Mbrojtjes, Lloyd Austin, pas vendimit të Shteteve të Bashkuara këtë javë për ta lejuar Kievin t’i godasë caqet brenda Rusisë në mënyrë të kufizuar.

Një zyrtar i Pentagonit tha se Austini e “ritheksoi përkushtimin e ShBA-së për mbështetje të fuqishme” për Ukrainën dhe se të dyja palët u zotuan “për ta përforcuar partneritetin strategjik në mbrojtje”.

Presidenti ukrainas u takua edhe me presidentin e zgjedhur indonezian, Prabowo Subianto, i cili kishte propozuar në samitin e njëjtë vitin e kaluar një plan indonezian për t’i dhënë fund luftës në Ukrainë. “Është e rëndësishme për ne ta fillojmë vendosjen e paqes së drejtë. Rusia nuk dëshiron t’i japë fund

luftës. Prandaj, ne duhet të punojmë së bashku patjetër me tërë botën për ta sjellë paqen më afër nesh”, tha Zelensky. Së fundmi, Zelensky tha se ai nuk i beson presidentit rus Vladimir Putin pas raportimeve se Bashkimi Evropian po mendon të organizojë bisedime për paqe me Rusinë.

Presidenti ukrainas tha se vendi i tij kishte mbajtur rreth 200 runde bisedimesh me Kremlinin shumë kohë para se Rusia ta fillonte pushtimin e plotë të Ukrainës në shkurt 2022, të cilat nuk kishin dhënë asnjë fryt.

Kina, e cila ka thënë se dëshiron paqe në Ukrainë, por i ka forcur marrëdhëniet me Moskën prej se filloi pushtimi, ka thënë se nuk do të marrë pjesë në samitin zvicëran.

## Netanyahu: S’mund të ketë armëpushim të përhershëm pa u shfarosur Hamasi

JERUSALEM, 2 QERSHOR - Kryeministri i Izraelit, Benjamin Netanyahu, ka thënë të shtunën se nuk do të ketë armëpushim të përhershëm në Rripin e Gazës pa u shkatërruar kapacitetet qeverisëse dhe ushtarake të Hamasit - grupit të shpallur terrorist nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian.

Ai e tha këtë përmes një komunikate online, një ditë pasi presidenti amerikan Joe Biden tregoi se Izraeli kishte propozuar një marrëveshje trefazore për armëpushim në Gazë, në këmbim të lirimit të pengjeve izraelite nga Hamasi. “Kushtet e Izraelit për t’i dhënë fund luftës nuk kanë ndryshuar: shkatërrimi i kapaciteteve



qeverisëse dhe ushtarake të Hamasit, lirimi i të gjitha pengjeve dhe garancia se Gaza nuk përbën kurrë më kërcënim për Izraelin”, tha Netanyahu.

Ai shtoi se Izraeli do të vazhdojë të ngulë këmbë “që këto kushte të plotësohen para se të zbatohet armëpushimi i përhershëm”. “Nuk ka asnjë shans që Izraeli të pajtohet për armëpushim të përhershëm pa u plotësuar këto kushte”, shtoi ai.

Ndërkohë Hamasi tha se është i gatshëm të angazhohet “pozitivisht dhe në mënyrë konstruktive” për çfarëdo propozimi që parasheh armëpushim të përhershëm, tërheqjen e forcave izraelite, rindërtimin e Gazës, kthimin e

të zhvendosurve dhe një shkëmbim “të mirëfilltë” të të burgosurve, “nëse Izraeli njofton qartazi se është i përkushtuar për marrëveshje të tillë”.

Izraeli e nisi luftën në Gazë si përgjigje ndaj një sulmi nga Hamasi në jug të Izraelit më 7 tetor, ku u vranë 1 200 njerëz, kryesisht civilë dhe u rrëmbyen rreth 250 të tjerë.

Izraeli thotë se më shumë se 100 pengje po mbahen ende në Gazë së bashku me trupat e pajetë të rreth 30 të tjerëve. Prej atëherë, lufta izraelite në Gazë i ka vrarë më shumë se 36 000 palestinezë, gjysma e të cilëve fëmijë dhe gra, sipas zyrtarëve shëndetësorë palestinezë.

## MPJD-ja e quan arbitrar arrestimin e shtetasit kosovar nga Serbia

Prishtinë, 2 qershor - Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës e Kosovës (MPJD) e ka dënuar si arbitrar arrestimin e një shtetasi kosovar nga autoritetet serbe të shtunën, duke thënë se i ka kërkuar bashkësisë ndërkombëtare të ndihmojë në lirin e tij të menjëhershëm.

Në një komunikatë për medie, MPJD tha se Zyra Ndërlidhëse e Kosovës në Serbi u njoftua të shtunën për arrestimin Tefik Mustafës nga autoritetet e Serbisë në pikëkalimin kufitar Merdar, për krime të pretenduara të luftës ndaj popullsisë joshqiptare gjatë luftës në Kosovë më 1999. Paraprakisht, Ministria e Brendshme e Serbisë njoftoi për media të shtunën pasdite për arrestimin e Mustafës.

MPJD tha se e dënon "ashpër ndalimin, arrestimin dhe



keqtrajtimin e qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe, njëkohësisht, i bën thirrje Bashkësisë Ndërkombëtare të ndërmarrë hapa konkretë për lirin e menjëhershëm të qytetarit Tefik Mustafa". Ajo i bëri thirrje bashkësisë ndërkombëtare të kërkojë përgjegjësi nga shteti

serb "për këto veprime arbitrar dhe destruktive, të cilat bien ndesh me konventat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut".

MPJD-ja shtoi se do të kërkojë zyrtarisht nga autoritetet serbe që ta lejojnë përfaqësuesin e zyrës së Kosovës në Serbi, Jetish Jashari, ta vizitojë Mustafën, "në

mënyrë që shteti dhe Qeveria e Kosovës të njoftohen më konkretisht për trajtimin që po i bëhet Mustafës nga organet serbe".

Për arrestimin e Mustafës, MPJD-ja tha se i ka njoftuar menjëherë vendet e QUINT-it në Kosovë dhe misionet diplomatike të Shteteve të Bashkuara dhe Britanisë së Madhe dhe të shteteve të tjera në Beograd.

"Zyra Ndërlidhëse e Republikës së Kosovës në Serbi i ka dërguar kërkesë zyrtare Zyrës Ndërlidhëse të Serbisë në Kosovë për konfirmim të arrestimit dhe për ofrimin e detajeve të tjera relevante, në të cilën kërkesë është përfshirë edhe Delegacioni i Bashkimit Evropian në Serbi", thuhet në njoftim.

Në tri vitet e fundit në Serbi janë arrestuar disa shtetas të Kosovës me dyshimet e pretenduara se

kanë kryer krime gjatë luftës në Kosovë 1998-99.

Më 17 prill autoritetet serbe e arrestuan shtetasin kosovar Sadik Duraku, i cili ka nënshtetësi britanike gjithashtu, i dyshuar "për krime lufte" më 1999 - akuza që u hodhën poshtë nga familjarët e tij. Duraku u arrestua në një vendkalim kufitar në mes të Kroacisë dhe Serbisë dhe një gjykatë serbe i caktoi masën e paraburgimit po atë muaj. Familjarët e tij thonë se akuzat kundër Durakut nuk qëndrojnë, pasi ai para luftës, në vitin 1999, ka jetuar me familjen e tij në Angli.

Në fillim të këtij viti kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, e akuzoi Serbinë për, siç i cilësoi ai, arrestime të padrejta, të qëllimshme dhe dashakeqe të qytetarëve të Kosovës.

## Kritikat e Kurtit ndaj Prokurorisë nga juristët vlerësohen vazhdimësi e ndërhyrjes në drejtësi

PRISHTINË, 2 QERSHOR - Kritikat e reja të kryeministrit Albin Kurti për mospunë të Prokurorisë Speciale në ndjekjen e krimeve të luftës po konsiderohen vazhdimësi e ndërhyrjeve të tij në drejtësi. Njohës të kësaj fushe thonë se kryeministri duhet ta përkrahë prokurorinë përmes buxhetit dhe ndryshimeve të nevojshme ligjore.

Kritikat e kryeministrit Albin Kurti ndaj Prokurorisë Speciale për performancë të dobët nuk janë të rralla gjatë mandatit të tij. Por këto të fundit lidhur me mosefikasitetin e Prokurorisë për ngritjen e aktakuzave për gjykim në mungesë për krimet e luftës, po vlerësohen si vazhdimësi e ndërhyrjeve të kryeministrit në drejtësi. "Deklaratat e tilla janë qartazi ndërhyrje në sistemin e drejtësisë dhe kjo përcaktohet sipas Kushtetutës dhe elaborohet tutje nga ana e opinionëve të Komisionit të Venecias. Çka i

takon kryeministrit, në rastin konkret, është t'i propozojë ndryshimet e nevojshme legjislative që janë bërë dhe e dyta, eventualisht, të tentojë ta përkrahë përmes ligjit për ndarje buxhetore Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës dhe këtu të përfundojë mandati i tij", ka thënë Gëzim Shala, hulumtues i lartë në Institutin e Kosovës për Drejtësi (IKD).

Megjithëse Shala vlerëson se Prokuroria nuk i ka dhënë ndonjë prioritet ndjekjes së këtyre krimeve, ai thotë se çdo deklarim tjetër i kryeministrit jashtë këtyre kufijve tregon qartazi ndërhyrje në Prokurorinë e Shtetit.

Me vlerësimet për ndërhyrje të Kurtit në punët e sistemit prokurorial pajtohen edhe avokatët. "Për mendimin tonë kjo nuk është e duhur dhe nuk duhet të përsëritet, apo të jetë shprehur nga asnjë pushtet e aq më pak nga ana e pushtetit



ekzekutiv i cili ka një linjë të komunikimit dhe varësisë nga Ministria e Drejtësisë, por edhe të aspektit financiar nga ME. Në situatat aktuale, pavarësisht prej rëndësisë që ka për sistemin ligjor, juridik, por edhe sigurimin e qytetarëve, nuk duhet të ketë deklarata që konsiderohen si ndërhyrje", është shprehur avokati Florim Shefqeti.

PSRK-ja reagoi një ditë më parë përmes një komunikate se deklarime të tilla nga kryeministri e minojnë besimin e qytetarëve dhe ndërhyjnë në pavarësinë e institucionit. Kurti ka kritikuar shpesh Prokurorinë gjatë pjesës së parë të këtij viti, kryesisht në përvjetorë të masakrave të kryera nga serbët. Kurse PSRK-në, Kurti e kishte kritikuar edhe në fundin e vitit të kaluar, për mosngritjen e asnjë aktakuze për sulmin terrorist në Banjskë. (rtv Dukagjini)

## Ambasadori italian në Serbi thotë se formimi i Asociacionit është kusht për pranimin e Kosovës në KiE



PRISHTINË, 2 QERSHOR - Ambasadori i Italisë në Serbi, Luka Gori, ka deklaruar se pranimi i Kosovës në Këshillin e Evropës duhet të lidhet me përparimin thelbësor në formimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. "Gjatë komitetit të fundit të Këshillit të Evropës, kjo çështje nuk u fut as në rend dite. Italia ishte një nga vendet që ishte në favor të shtyrjes së pranimi. Ne besojmë se pranimi duhet të lidhet me përparimin thelbësor

në formimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Është një nga kushtet që duhet të plotësohet në mënyrë që kandidatura e Kosovës të ketë sukses", ka thënë Gori në një intervistë për mediet serbe.

I pyetur se pse Italia votoi për miratimin e Rezolutës për Srebrenicën në OKB, ambasadori u përgjigj se qëndrimi i Romës zyrtare për këtë çështje dihet. "Kjo ishte një nga temat e bisedës në mes të ministrit Tajani dhe

kryeministrit Vuçeviq në Trieste. Ne dëgjuam me kujdes dhe në frymë miqësore argumentet dhe atë që kishte për të na thënë pala serbe. Qëndrimi ynë për rezolutën dihet. Vota është një fakt. Tani ne shikojmë më tej me synimin për ta ruajtur bashkëpunimin dhe stabilitetin në rajon", tha Gori.

Kosova nuk u fut fare në rendin e ditës të takimit të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës që u mbajt më 16 dhe 17 maj.



# Kurti pritet ta përfundojë në tërësi mandatin, skepticizëm për zgjedhje në vjeshtë

Analistët politikë kanë theksuar se Qeveria e Kosovës pritet ta përfundojë në tërësi mandatin deri në shkurt të vitit 2025 pas dështimit për të arritur një konsensus me partitë opozitare për shpërndarje të Kuvendit. Megjithëse kryeministri Albin Kurti ka shprehur pëlqimin që zgjedhjet të mbahen në vjeshtë, kjo po shihet e pamundur nga analistët politikë

**PRISHTINË, 2 QERSHOR** - Qeveria e Kosovës pritet ta përfundojë në tërësi mandatin deri në shkurt të vitit 2025, pas dështimit për të arritur një konsensus me partitë opozitare për shpërndarje të Kuvendit. Megjithëse kryeministri Albin Kurti ka shprehur pëlqimin që zgjedhjet të mbahen në vjeshtë, kjo po shihet e pamundur nga analistët politikë. Sipas tyre, Ligji për Zgjedhje të Përgjithshme parasheh që zgjedhjet e rregullta të mbahen jo më herët se 60 ditë para përfundimit të mandatit, ndërsa konsiderojnë se për zgjedhje të parakohshme nuk pritet të ketë vullnet opozita pas dështimit të mbajtjes së tyre në qershor. Megjithatë, në partinë në pushtet, Lëvizjen

Vetëvendosje, tregojnë gatishmërinë për zgjedhje kurdo që paraqitet mundësia brenda këtij viti. Deputetja e LV-së, Fitore Pacolli, thotë se kurdo që ka pajtim ndërmjet partive opozitare, janë të gatshëm për zgjedhje. “Ne kemi thënë se jemi të gatshëm të shkojmë në zgjedhje të reja kurdo që paraqitet mundësia. Kurdo që ka pajtim ndërmjet partive opozitare, ne e kemi thënë kohë më parë se jemi të gatshëm të shkojmë në zgjedhje. Opozita nuk është e gatshme dhe është tërhequr prej kërkesave që i ka pasur që tri vjet”, thotë ajo. Mirëpo, skeptik për zgjedhje të parakohshme në vjeshtë, apo qofshin të rregullta, ka

shprehur analisti politik Artan Muhaxhiri. Ai thotë se nuk ekziston ndonjë momentum opozitar që zgjedhjet e parakohshme të mbahen në vjeshtë. Sipas tij, opozita është e përçarë për t’ia ndërprerë Kurtit mandatin, ndërsa thotë se në bazë të legjislacionit do të jetë e pamundur që zgjedhjet e rregullta të mbahen në vjeshtë. “Nuk ekziston ndonjë momentum opozitar i cili do ta nxiste kryeministrin Kurti për zgjedhje të parakohshme. Ai është komfort në pozicionin e tij dhe nuk ka ndonjë rrezikim, pasi opozita është e përçarë dhe ka dallime të mëdha. Më shumë duket ndonjëherë se ka dallime më të mëdha opozita ndërmjet vete sesa në raport me kryeministrin Kurti dhe LV-

në. Duket se ishte vetëm një manovër për një plan eventual në të ardhmen, pra takimi në mes të Kurtit dhe kryetarit të PDK-së, Memli Krasniqi. Do të jetë zhgënjyese sepse në këta muaj të mbetur nuk do të ketë mundësi për zhvillime kualitative. Kosova është në sanksione. Dialogu nuk pritet të vazhdojë. Njëjtë edhe raporti i bashkësisë ndërkombëtare ndaj Kosovës nuk ka asnjë indikacion se do të ndryshojë pozitivisht”, ka deklaruar Muhaxhiri. Edhe analisti Arbnor Sadiku thotë se qeveria Kurti do të jetë ekzekutivi i parë që përfundon mandatin deri në fund. Madje ai parasheh që partia në pushtet, LV, të përafrohet me PDK-në në një koalicion të ardhshëm qeveritar. “Gjasat janë që të kemi zgjedhje të rregullta dhe natyrisht konsensusi do të jetë ndërmjet partive politike. Në zgjedhjet e radhës si duket LV-ja do të duhej të jetë në koalicion qoftë me PDK-në dhe LDK-në për ta arritur zgjidhjen e presidentit në pako. Sa i kemi parë aktivitetet e fundit, afërsia ka

qenë me PDK-në dhe gatishmëria ka qenë më e madhe për shkak të problemeve të brendshme që i ka PDK-ja. Kurse LDK-ja si duket është e vendosur të jetë edhe një mandat në opozitë dhe të mundohet ta ruajë Prishtinën me çdo kusht. Kurse sa i përket AAK-së, nuk ka qenë e gatshme të hyjë në zgjedhje se nuk ka pasur asnjë premtim nga LV-ja që do ta marrë në koalicion”, ka theksuar ai për “Kp”. Gjatë kësaj jave kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, bëri me dije se, sipas tyre, është ezauruar mundësia për zgjedhje të parakohshme pas dështimit të shpërndarjes së Kuvendit brenda muajit maj. Kundër shpërndarjes së Kuvendit janë deklaruar në LDK dhe AAK. Ata kërkojnë dorëheqjen apo shkarkimin e kryeministrin Kurti më pastaj vetëdorëheqjen e deputetëve. Kryeministri Albin Kurti është shprehur i gatshëm për zgjedhje të parakohshme brenda këtij viti, por vetëm përmes shpërndarjes së Kuvendit.

# Gashi thotë se Kurti iu përgjigj ftesës së madhe të shqiptarëve opozitarë për një rrotacion politik në Maqedoni

SHKUP, 2 QERSHOR - Integrimi i shpejtë i Maqedonisë së Veriut në Bashkimin Evropian mbetet prioriteti ynë si shtet, por edhe i përfaqësuesve të partive politike shqiptare, thotë në një intervistë për Radion Evropa e Lirë, kryetari i ri i Kuvendit të Maqedonisë së Veriut, Afrim Gashi. Sipas tij, për këtë nevojitet dialogu me të gjitha palët, si brenda ashtu edhe jashtë vendit, para së gjithash me shtetet fqinje.

Për ndryshimet kushtetuese, të nevojshme për përfshirjen e pakicës bullgare në preambulën e saj, nevojiten dy të tretat e votave, të cilat Gashi thotë se partitë që do ta formojnë qeverinë e re, do të arrijnë t'i sigurojnë dhe më pas të ketë një debat "për të hequr nga tryeza këtë problem politik".

Ai thotë se me hapjen e ndryshimeve kushtetuese do të angazhohet që të zgjidhet edhe statusi i gjuhës shqipe në Kushtetutë, e cila përkufizohet si gjuhë e "20 për qind" të popullsisë.

Ai në intervistën për REL-in reagoi edhe ndaj pohimeve të

partisë E Maja, e cila akuzoi koalicionin VLEN dhe VMRO DPMNE për "kosovarizimin" e Kuvendit të Maqedonisë së Veriut. "Mendoj se fjalori që u përdor atë ditë ishte më shumë një performancë teatrale për ngritje të tensioneve dhe tërheqje të vëmendjes", thotë Gashi. "Nuk mund të kërkojmë vota nga të gjitha komunitetet dhe pastaj të thirrsh në legjitimitetin e shqiptarëve", thotë Gashi lidhur me pohimet e BDI-së se është shkelur legjitimiteti i votës shqiptare.

Ai thotë se si drejtues i Kuvendit do të jetë i hapur për bashkëpunim me të gjitha partitë dhe se do t'i respektojë të gjitha qëndrimet e tyre me qëllim të forcimit të demokracisë parlamentare në vend.

Gashi ka folur edhe për mbështetjen e LV-së për VLEN. "Ne kemi raporte të mira me të gjitha subjektet politike edhe në Shqipëri edhe në Kosovë, por edhe në rajon. Natyrisht, është botërisht e ditur se Lëvizja Vetëvendosje ka dalë hapur dhe e ka përkrahur koalicionin VLEN. Një nga eksponentët e



Vetëvendosjes që është nga Maqedonia e Veriut, z. Bekim Qoku, ishte në listën për deputet dhe është zgjedhur deputet i këtij koalicioni. Kështu që, raporti ynë s'do mend se është i afërt dhe mendoj se Vetëvendosja ka përkrahur një thirrje të shqiptarëve të Maqedonisë së

Veriut, që janë simpatizues të Vetëvendosjes e që janë qytetarë të Maqedonisë së Veriut e që e kanë dashur ndryshimin te shqiptarët në këtë vend. Unë mendoj se Vetëvendosja dhe zoti [Albin] Kurti i janë përgjigjur kësaj ftese të madhe të shqiptarëve opozitarë për një ndryshim dhe për një rrotacion

politik. Nuk është kjo një mbështetje në bllok për vetëm për një strukturë politike, por më shumë është një nevojë për ndryshim që e kanë ndierë edhe shqiptarët në përgjithësi, sidomos votuesit dhe simpatizuesit e Vetëvendosjes që janë qytetarë të Maqedonisë së Veriut", ka thënë Gashi.

## Çitaku: S'kemi shtiza për kolegët në opozitë, jemi në garë me LV-në

PRISHTINË, 2 QERSHOR - Sekretarja e përgjithshme e Partisë Demokratike të Kosovës, Vlora Çitaku, thotë se "shtizat" nuk i kanë për partitë e tjera opozitare, ndërsa garën e ngushtë e sheh ndërmjet Partisë Demokratike të Kosovës dhe Lëvizjes Vetëvendosje. Beson se qeverinë, pas zgjedhjeve, do ta udhëheqë kandidati i PDK-së, Bedri Hamza.

Çitaku në një bisedë për Ekonomia Online ka theksuar domosdoshmërinë për të shkuar në zgjedhje sa më parë për shkak të dëmeve që po i shkaktohen vendit nga Qeveria Kurti. Sipas ish-ministres së Integritetit, ka regres të madh në ekonomi në këto tri vjet e gjysmë, aleatët tanë kanë humbur besimin në udhëheqësit e institucioneve të Kosovës dhe për fajin e kësaj qeverie po ndodh migrim masiv. Ajo ka mohuar kategorikisht se ka pasur ndonjë marrëveshje me Lëvizjen Vetëvendosje për koalicion pas zgjedhjeve. "Nuk ka asnjë lloj marrëveshje mes PDK-së dhe LV-së, përveç kërkesës sonë si PDK që vendi sa më parë të shkojë në zgjedhje dhe mandati t'u kthehet



qytetarëve. Kjo jo si dëshirë, por si nevojë dhe si domosdoshmëri. Vendi është në stagnim, kemi shënuar një regres të frikshëm në ekonomi, parametrat në migrim janë të tmerrshme, aleatët tanë kanë humbur besimin tek udhëheqësit e institucioneve të Republikës së Kosovës dhe ne po insistojmë që të kemi zgjedhje sa më parë në mënyre

që të ndalet ky degradim. Nuk kemi shtiza për kolegët tanë në opozitë. Nuk jemi në garë me ta. Ne jemi në garë me Albin Kurtin dhe LV-në. Po synojmë që mandatin t'ua kthejmë qytetarëve në mënyrë që Kosovës t'i vijë një qeverisje e përgjegjshme në krye me kryeministrin e ardhshëm Bedri Hamza", thotë Çitaku. Çitaku thotë se mundësia e

vetme që të shkohet në zgjedhje është përmes shpërndarjes së Kuvendit, teksa dorëheqjen e Kurtit s'e sheh të realizueshme, ndërsa përmend faktin se opozita nuk i ka votat e mjaftueshme për ta rrëzuar qeverinë. Kritikati i hedh edhe në adresë të partive të tjera opozitare, për të cilat thotë se nuk e kanë qëllimin e njëjtë - shkuarjen në

zgjedhje të parakohshme. "Situata është shumë e thjeshtë. Tani për tani mënyra e vetme për të shkuar në zgjedhje është shpërndarja e Kuvendit. Për shkarkim të qeverisë nuk i kemi votat. E tërë opozita bashkë i ka 40 deputetë, ndërkaq dorëheqja nuk diktohet nga kërkesa jonë. Ajo është vendim i kryeministrit aktual dhe nëse të gjithë po pajtohemi që Kosova i ka punët keq, që vendi është duke shkuar në drejtim të gabuar, atëherë prioriteti ynë duhet të jetë qëllimi, e qëllimi është organizimi i zgjedhjeve sa më parë. Megjithatë kam drojë që dritarja për një vendim të tillë po ngushtohet. Jemi munduar që në këtë proces si PDK të jemi konsistent në kërkesën tonë për zgjedhje të reja qysh nga korriku i vitit të kaluar dhe të jemi bashkëpunues e përafres dhe mos ta përdorim këtë situatë për ta sulmuar njëri-tjetrin", thotë tutje Çitaku. Koordinimin me partnerët ndërkombëtarë, Çitaku e sheh jetik për funksionalizimin e shtetit. Këtë fakt e sheh si të munguar për fajin e qeverisë Kurti. Ajo përmend edhe sanksionet e vendosura nga Bashkimi Evropian.

# Rryma për veriun: S'ka kompensim për milionat e shpenzuara deri më 2012

PRISHTINË, 2 QERSHOR - Qytetarët e Kosovës e kanë humbur të drejtën e tyre ligjore për kompensim për faturat e rrymës që kanë paguar në emër të banorëve të katër komunave veriore nga viti 1999 deri më 2012.

Avokati i Popullit i Kosovës, Naim Qelaj, shpjegon për Radion Evropa e Lirë se kërkesat për kthim të borxhit ose dëme të shkaktuara mund të bëhen në mënyrë retrospektive për vetëm pesë vjet, në të kundërtën afati ligjor për ushtrimin e kësaj të drejte skadon. Nga Instituti i Kosovës për Drejtësi pohojnë të njëjtën gjë, duke thënë se, bazuar në Ligjin për marrëdhëniet e detyrimeve, qytetarët e kanë humbur tashmë të drejtën e kompensimit për faturat e paguara për 13 vjet.

Nga 1 qershori i këtij viti do të nisë kompensimi i tyre vetëm për faturat e paguara nga viti 2012 deri më 2017, proces ky që do të zgjasë deri në vitin 2030.

Ky vendim është marrë muajin e kaluar bazuar në një padi të ngritur nga Avokati i Popullit në vitin 2017. Me kërkesë të gjykatës, Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) i obligoi shërbimet e shpërndarjes së energjisë elektrike që t'i kompensojnë konsumatorët. Interesimit të REL-it për ta komentuar këtë temë, Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), që ishte përgjegjëse për faturimin, nuk iu përgjigj. Nuk u përgjigj as kompania për furnizim me energji, KESCO.

## Pse qytetarët në veri s'e paguan rrymën?

Banorët e komunave Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq - shumica serbë - nuk paguan për rrymën e shpenzuar që nga përfundimi i luftës, më 1999. Refuzimi erdhi si pasojë e mosbindjes qytetare, por edhe ndikimit të strukturave të



ndryshme atje, që operonin sipas sugjerimeve të Serbisë.

Deri në fund të vitit 2017 rrymën e shpenzuar në veri e paguan qytetarë të pjesëve të tjera të Kosovës të cilët merrnin fatura me rritje. Nga 2017-ta e këndej - pas ankesave të shumta të qytetarëve dhe padisë së ngritur nga Avokati i Popullit - përgjegjësia për pagesën kaloi tek Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut i Kosovës, KOSTT, ndërsa subvencione ndau edhe Qeveria e Kosovës.

Në vitin 2022, pastaj, Kosova dhe Serbia u pajtuan për zbatimin e një marrëveshjeje për energjinë, të arritur qysh në vitin 2013, në kuadër të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve. Në praktikë kjo marrëveshje nisi të zbatohet në fund të shkurtit.

Gjykata Themelore në Prishtinë e mori vendimin për kompensim në vitin 2021, me të cilin kërkoi

kthimin e mbi 40 milionë eurove te qytetarët e Kosovës. Vendimi pastaj u vërtetua edhe nga Gjykata e Apelit dhe ajo Supreme, ndërsa në mars të këtij viti edhe nga Gjykata Kushtetuese.

Në një intervistë dhënë REL-it më 13 prill, kreu i Bordit të ZRRE-së, Ymer Fejzullahu, nuk ka dha informacione konkrete se nga sa euro në muaj do të kompensohen konsumatorët për periudhën 2012-2017. Kësaj pyetjeje nuk iu përgjigjën as kompanitë për furnizim me energji, përkatësisht inkasim të energjisë, KESCO dhe KEDS.

Duke folur për Radion Evropa e Lirë, Avokati i Popullit, Naim Qelaj, thotë se vendimi i gjykatës për kompensimin e qytetarëve vetëm për pesë vjet u mor pasi që rasti për këtë çështje u ngrit në vitin 2017. Me ligj, kujton ai, periudha retrospektive nuk mund të shkojë përtej pesë vjetësh.

Kësaj deklarate i bën jehonë edhe Gëzim Shala nga Instituti i Kosovës për Drejtësi. "Nëse flasim për borxhet përpara vitit 2012, sipas Ligjit për marrëdhënie të detyrimeve, tanimë kjo kërkesë është parashkruar [v.j. vjetruar] dhe nuk ka më mjet juridik për ta fituar në gjykatë. Në situatën në të cilën jemi, kjo e drejtë tanimë është e humbur", thotë Shala.

Si Qelaj ashtu edhe Shala konsiderojnë se faturimi i shpenzimeve të rrymës së shpenzuar në veri te qytetarët e pjesëve të tjera të vendit ishte shkelje e të drejtave të njeriut. "Në raport me shkeljen e të drejtave të qytetarëve, në këtë rast të konsumatorëve, shkeljet kanë ndodhur në çdo moment kur ka pasur faturim të kësaj natyre", thotë Avokati i Popullit.

Shala shton se qytetarëve u janë shkelur disa të drejta: ajo për pronë, për shkak se kanë paguar

shërbimet që nuk i kanë marrë, pastaj e drejta e barazisë para ligjit dhe e drejta e konsumatorëve. "Të gjitha këto janë konstatuar nga tri shkallët e gjykatave dhe të gjitha këto më pas janë konfirmuar edhe nga Gjykata Kushtetuese përmes një aktgjykimi të nxjerrë", thotë Shala.

Disa qytetarë me të cilët bisedoi Radio Evropa e Lirë në Prishtinë shprehen të zhgënjyer me faktin që s'do të kenë kompensim për faturat që paguan nga viti 1999 deri më 2012. "Ti paguan për diçka që ke përdorur. Diçka që nuk ke përdorur, nuk ke nevojë ta paguash", thotë Muhamet Ahmeti. "Të më thuash se 'unë ty po të sjell drejtësi', e cila nuk është drejtësi, sigurisht se e ndien veten të fyer. Kjo nuk është drejtësi", thotë ai.

"Ata 13 vjet nuk zhbëhen kurrë", thotë Drita Mengjiqi. "Ne jemi të shkelur dhe të drejtat tona janë shkelur. Ne jemi të plaçkitur prej shtetit", shprehet ajo.

Hanumshahe Ibrahim thotë se shkelja e të drejtave të qytetarëve, në një mënyrë, është përligjur, sepse nuk ka as mundësi ankese. "Unë nuk shoh adresë për ankesë. Gjykatat po shkojnë shumë ngadalë... unë nuk shoh adresë", thotë ajo.

Në muajin prill Radio Evropa e Lirë pyeti Korporatën e Energjisë Elektrike se sa paguan më shumë qytetarët jashtë veriut për rrymën e shpenzuar në veri nga viti 1999 deri më 2012. Të njëjtën pyetje e përsëriti edhe javën e kaluar, por deri në publikimin e këtij artikulli nuk mori përgjigje.

Në vitin 2012 zyrtarë të KEK-ut patën deklaruar për REL-in se borxhi i përgjithshëm i konsumatorëve në veri, që nga përfundimi i luftës e deri atëherë, vlerësohej të ishte mbi 100 milionë euro. Vlera e përgjithshme e faturave vjetore për katër komunat atje, sipas të dhënave zyrtare, arrinte nga 8 deri në 10 milionë euro.

## Tahiri: Kurti nuk heq dorë nga privilegjet dhe xhipat e zi

PRISHTINË, 2 QERSHOR - Shefi i grupit parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Besnik Tahiri, ka theksuar se këtë muaj opozita duhet të përbashkohet, ndërsa ne si Aleancë kemi për të punuar e pyetur qytetarët e Kosovës", thotë ai.

Më tej, ai ka treguar se do t'i pyesin qytetarët lidhur me ndryshimet që ka bërë qeveria Kurti gjatë këtyre viteve. "A jeni duke jetuar më mirë se para tri viteve? Çka ka ndryshuar në jetën tuaj në sektorin e shëndetësisë? A e keni Ligjin e Sigurimit Shëndetësor? Çka ka ndryshuar në sektorin e arsimit? Çka ka ndryshuar te

nga privilegjet e shumta e nga xhipat e zi që dikur i 'urrente' Në këta muaj opozita duhet të përbashkohet, ndërsa ne si Aleancë kemi për të punuar e pyetur qytetarët e Kosovës", thotë ai.

Më tej, ai ka pohuar se "suksesin kryesor të opozitës në muajt në vijim e shoh atëherë kur ajo e detyron qeverinë të përgjigjet në këto pyetje dhe nuk merret me njëri-tjetrin". "Ne si parti do të shtrojmë pyetje e do t'i ofrojmë alternativat. Aleanca i ka alternativat. Do t'i shihni e do t'i debatojmë tani e tutje", shkruan Tahiri në "Facebook".

policët e Kosovës. Po të shërbyesit civilë? Çka ka ndryshuar në ekonomi? A e keni jetën më të mirë apo është vështirësuar për shkak të pagës së ulët dhe çmimeve të larta?", pohon Tahiri.

Më tej, ai ka pohuar se "suksesin kryesor të opozitës në muajt në vijim e shoh atëherë kur ajo e detyron qeverinë të përgjigjet në këto pyetje dhe nuk merret me njëri-tjetrin". "Ne si parti do të shtrojmë pyetje e do t'i ofrojmë alternativat. Aleanca i ka alternativat. Do t'i shihni e do t'i debatojmë tani e tutje", shkruan Tahiri në "Facebook".



# Gërxhaliu: Superpuna, zhgënjim dhe demotivim për të rinjtë kosovarë



## Safet GËRXHALIU

Mungesa e një strategjie zhvillimore apo e një plani nacional për zhvillim të qëndrueshëm krijon hapësira manovruese dhe eksperimentuese me prapavijë politike dhe jo sociale e ekonomike.

Është utopike të mendohet se pa zhvillim ekonomik dhe sektor të fuqishëm privat mund të arrihet stabiliteti social dhe të rritet punësimi. Dialogu publiko-privat, investimet e huaja dhe stabiliteti politik janë parakushte për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik e këto

Kosovës i mungojnë aktualisht. Nuk zgjidhet problemi i papunësisë me vendime ad-hoc dhe me qasje politike. Superpuna është promovuar politikisht por më se paku ka luajtur rolin për çfarë është krijuar dhe për çfarë promovohet nga qeveria.

Shifra shumë të larta të aplikimeve që aplikojnë aty (sipas tyre), ndërsa as 10 % të tyre nuk ftohen as në intervistë të parë, i bie që vetëm për keqpërdorime të fondeve të shpallen shumica e konkurseve.

Në disa konkurse u kërkohet të kenë diploma të fakulteteve plus përvojë pune paraprake nga kandidatët, ndërsa kriteri kryesor nga Superpuna është që mosha e tyre duhet të jetë 18-29 vjeçare, dhe lind pyetja kur ta përfundosh fakultetin dhe pastaj ta bësh përvojën p.sh. 5 vite para aplikimit? Sidomos fakultetet më të vështira apo me afat të gjatë, aq më pak nëse nuk ftohen as në intervistë që aplikojnë.

Thuhet që nuk ka kuadro të reja në Kosovë, se punë dhe paga ka, në rastin konkret nga një konkurs i një biznesi, aplikojnë mbi 25 kandidatë, dhe nga aty ka kandidatë që kanë diplomuar jashtë Kosovës dhe janë kthyer dhe kanë punuar në markete apo

fastfood me pagë minimale që lejon ligji. Pastaj mbi 80% e këtyre kandidatëve falënderohen që janë ftuar në intervistë dhe tregojnë që është hera e parë që u ftuan për intervistë nga mbi 20 aplikime që kanë bërë deri tani.

Nga një proces i tillë, përfitimet janë kryesisht në favor të pronarëve të bizneseve private, ndërsa suksesi i procesit mbetet i kufizuar. Kompanitë janë kryesisht të përqendruara në legalizimin e punëtorëve të palegalizuar ekzistues, dhe jo në punësimin e të rinjve. Për më tepër, vetë procesi nxjerr në pah mosfunksionimin dhe burokracinë e administratës shtetërore, me vonesa deri në 2-3 muaj për ekzekutimin e pagesave. Një qasje e tillë e gabuar vetëm demotivon të rinjtë që janë aset dhe vlerë e Republikës së Kosovës dhe pas këtij zhgënjimi çka ju mbetet tjetër përveç për t'u larguar nga Kosova me biletë njëdrejtmëshe.

# Thirrje për qeverinë t'i përmbushë kushtet për të përfituar nga fondi 6-miliardësh i BE-së

PRISHTINË, 2 QERSHOR - Oda Ekonomike e Kosovës (OEK) dhe Këshilli i Investitorëve Evropianë (EIC) i kanë bërë thirrje qeverisë të jetë vigjilente për përmbushjen e kushteve që i janë vendosur Kosovës në mënyrë që vendi të mos humbas shansin të përfitojë nga fondi 6 miliardë euro i Bashkimit Evropian në kuadër të Planit të ri të Rritjes për vendet e Ballkanit Perëndimor.

Ata kanë thënë se kërkesa e shefit të zyrës së BE-së në Prishtinë, Tomas Szunyog, që Kosova sa më shpejt ta heqë ndalimin e produkteve serbe në mënyrë që të përfitojë nga ky plan, duhet të shqyrtohet me kujdes nga institucionet e vendit.

Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Luzim Rafuna, ka thënë se qeveria duhet të jetë shumë e kujdesshme sa i përket implementimit të planit zhvillimor në mënyrë që t'i përmbushë kushtet të cilat kërkohen për të përfituar nga ky



plan pasi, sipas tij, nëse vendi dështon në përmbushjen e kushteve, mjetet e dedikuara për Kosovën u shkojnë vendeve fqinje. "Edhe më herët kemi kërkuar të jemi shumë të kujdesshëm sa i përket implementimit të planit

zhvillimor. Në qoftë se ne e humbim hapin ose nëse nuk i përmbushim kushtet të cilat na kërkohen, atëherë këtu nuk do të jetë vetëm humbje kohë siç na ka ndodhur te liberalizimi i vizave, që humbëm kohën për dhjetë vjet, sepse këtu do të humbasim

edhe materialisht për arsye se shuma e mjeteve që është e paraparë për Kosovën, në rast se nuk arrihet për t'u shpenzuar për shkak se nuk i ke plotësuar kushtet, ajo shumë e mjeteve u shpërndahet vendeve të Ballkanit, pra përfitojnë vendet

tona fqinje. Për këtë arsye duhet të jemi shumë të përpiktë për plotësimin e kushteve që kërkohen dhe të jemi në koherencë me të gjitha vendet e tjera gjatë fazave të implementimit që mos të ngecim. Në planin zhvillimor është bërë shumë e qartë se në rast se një shtet nuk i plotëson kushtet do ta ndalë veten. Për këtë arsye kërkesa jonë vazhdon që ne të jemi shumë të përpiktë. Edhe OEK-u për pjesën brenda kompetencave dhe mundësive që i ka do të jetë 24 orë në shtatë ditë të punës për t'i ndihmuar institucionet për plotësimin e kushteve", ka thënë ai.

Drejtori ekzekutiv i Këshillit të Investitorëve Evropianë, Emrush Ujkani, ka thënë se për vendet e Ballkanit është shumë i rëndësishëm bashkëpunimi ekonomik pasi, sipas tij, vetë integrimi në BE nuk mund të ndodhë pa pasur një integrim të mirëfillt brenda vetë rajonit. (EO)

## Dogana dhe policia sekuestrojnë 33 kilogramë ari

PRISHTINË, 2 QERSHOR - Dogana e Kosovës, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, ka bërë kontrollë në rajonin e Gjilanit pas pranimit dhe verifikimit të informatave për dyshime për tregti të paligjshme nga disa biznese që ushtrojnë veprimtarinë e argjendarive. "Në kuadër të këtij operacioni janë kontrolluar shtatë lokacione të ndryshme, ku janë

gjetur dhe sekuestruar përkohësisht: 33 kg e 310 gramë ari (tridhjetë e tre kilogramë e treqind e dhjetë gramë ari), 14 650.00 euro (katërmëdhjetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë euro) dhe 9 720.00 franga zvicerane (nëntë mijë e shtatëqind e njëzet franga zvicerane). Gjatë këtij operacioni janë arrestuar gjashtë persona të dyshuar, të

gjithë meshkuj kosovarë. Pas intervistimit të tyre, me vendim të prokurorit kujdestar, të arrestuarit janë dërguar në mbajtje", ka njoftuar Dogana. Policia e Kosovës dhe Dogana e Kosovës kanë njoftuar se mbeten të përkushtuara kundër aktiviteteve të paligjshme dhe korrupsionit, duke garantuar siguri dhe rend për të gjithë qytetarët.




# Shqiptarët dhe forca shkatërrimtare ndaj objekteve të trashëgimisë!

Nga: Machiel KIEL (*pasthënia e librit Arkitektura Osmane në Shqipëri: 1385-1912*)

Fillimisht, më se 40 vite më parë, planifikoja të kryeja një punim madhor për trashëgiminë osmane në Ballkan. Shumë shpejt u bë e qartë se një punim mbi Hungarinë nuk përbënte prioritet parësor, sepse sasia e vogël e monumenteve që mbijetonin në këtë vend ishin studiuar tashmë. E njëjta gjë vlente po ashtu edhe për Jugosllavinë, vend në të cilin veprat e rëndësishme të arkitekturës osmane ishin studiuar mirë e botuar që prej vitit 1925. Kështu, vendosa të shkruaj një trilogji me vëllime për Shqipërinë, Bullgarinë dhe Greqinë. I shkrova të tria pjesët e trilogjisë, por vija vazhdimisht t'i përmirësoja tekstet dhe përfundimisht c kuptova që do të më duhej t'i rishkruaja duke ua shtuar të dhënat e vyera që gjendeshin në Arkivat Osmane në Stamboll, dhe në një masë më të vogël në Ankara dhe në Sofje. Pas vitit 1983, m'u mundësua të zhvilloja hulumtimet disamujore në arkivat e Turqisë dhe kështu, më 1990, munda ta përfundoj vëllimin mbi Shqipërinë duke shtuar shumë materiale burimore osmane.

Baza e studimit tim mbi Shqipërinë osmane ishin tri vizitat e mia në vend si turist. Nuk m'u dha asnjë leje nga autoritetet shqiptare për të kryer hulumtime në vend. Në këto kushte, përfundimi i një shqyrtimi të plotë i monumenteve osmane ishte bërë krejt i pamundur dhe, për pasojë, shumë syresh i shpëtuan vëmendjes sime. Kjo është veçanërisht e vlefshme për urat e vjetra dhe teqetë monumentale të dervishëve bektashinj që gjendeshin në fshatra dhe jashtë qendrave urbane, udhëtimi drejt të cilave ishte rreptësisht i ndaluar. Në qytetet që përmbante programi ynë turistik, përgjatë gjithë të cilit shoqëroheshim, na lejohej të fotografonim ndërtesa të ndryshme historike. Bëra edhe skica planimetrish. Dy apo tri vajza vërtet të pashme të grupit tonë, i mbanin shoqëruarit të zënë, ndërsa unë, së bashku me një koleg me të cilin me të cilin kisha punuar për vite të tëra në Shërbimin Kombëtar të Monumenteve Historike në Holandë, nxitonim të kryenim disa matje themelore të ndërtesave që vizitonim.

Gjatë vizitës së dytë, më 1978, pjesë e grupit tonë ishte baronesha Van Heemstra, trashëgimtare një familjeje të vjetër fisnikësh holandezë. Asaj i



pëlqeu mjaft mënyra ime e drejtimit të vizitës dhe "metoda" jonë e matjes së ndërtesave të vjetra. Në fund të udhëtimit, ajo më mundësoi njohjen me vëllain e saj, baronin Van Heemstra, i cili ishte ambasadori i Madhërisë së Saj në Beograd, i akredituar gjithashtu edhe në Shqipëri. Baronit Van Heemstra ia dhashë kopjet e skicave të mia planimetricke dhe në një prej vizitave të tij zyrtare në Shqipëri, ai i bëri një vizitë Institutit të Monumenteve të Kulturës në Tiranë dhe u kërkoi studiuesve të atjeshëm t'i kontrollonin ato dhe, nëse ishte e nevojshme, t'i korrigjonin. Përfundimisht, të gjitha korrigjimet u kryen më së miri. Gjatë udhëtimit tim të fundit, më 1983, u takova me disa anëtarë të Institutit të Monumenteve të Kulturës, Emin Rizën, Aleksandër Meksin, Gjerak Karaiskajn, Sulejman Dashin etj. Me këtë rast, ata më dhuruan disa fotografi të vjetra të monumenteve osmane dhe të dhëna të tjera të vyera dhe nisën të më dërgonin çdo numër të revistës Monumentet – deri në vitin 1991. Gjatë këtij viti u botua edhe numri i fundit i periodikut më se të shkëlqyer, Monumentet, i cili më pas reshti së botuari.

Prej Revolucionit Kulturor të vitit 1967, ruaj në kujtesë minaret e gjata që shtriheshin në një prej rrugëve kryesore të Shkodrës, duke e bllokuar tërësisht trafikun. Në vende të tjera vumë re letra të vogla udhëzimesh, të cilat u mësonin njerëzve si të shkullnin minaret. Nuk na lejuan t'i fotografonim këto copa letrash tejet udhëzuese. Më 1967, vizitova xhaminë e Peqinit, ende në

gjithë lavdinë e saj. Më 1978 vetë xhamia ishte shkatërruar, por hajati i dyfishtë i pikturuar aq bukur (tipik shqiptar) ishte shndërruar në kafene. Më 1983 ishte zhdurur gjithçka, duke dëshmuar kështu se forca shkatërrimtare ishte më e forte se ajo ruajtëse. Në punimet e mia për arkitekturën osmane në Shqipëri, shkatërrimin e komplekseve të xhamive të Kavajës dhe Peqinit e kam quajtur "sakrificë barbare azteke" gjatë së cilës prifti shkull nga trupi i gjallë zemrën që rreh. Në vigjiljen e erës së re i shkrova një letër zyrtare autoriteteve shqiptare, përmes së cilës i këshilloja të merrnin parasysh mundësinë e rindërtimit të disa prej ndërtesave më të rëndësishme, tashmë të shkatërruara, dhe t'i rimëkëmbnin ato me besnikëri sipas planimetricke, vizatimeve, skicave dhe fotografive që ruhen në arkivat e tyre. Këtë janë duke e bërë sot njerëzit në Bosnjë, në vendet si Foça mbi Drinën, në Banja-Llukë me Ferhadijen madhështore. Në Mostar kanë rindërtuar ndërtesa të shkatërruara më 1948, në kuadrin e politikave anti-fetare të fillimeve të regjimit të Titos, asokohe në linjë të drejtpërdrejtë me Moskën. Këto ndërtesa ishin shtuar për më se gjysmë shekulli, ndërsa tashmë, që prej vitit 2000, kurorëzojnë kodrën që mbizotëron Urën e Vjetër (Xhamia c Nazirit), dhe gjallërojnë hyrjen e njërës prej rrugëve kryesore të qytetit të vjetër (Xhamia Tere Jahjës). Nuk mora kurrë përgjigje mbi letrën time dërguar Tiranës.

Monumentet osmane në Shqipëri janë të përmasave relativisht të vogla dhe arsyet e kësaj dukurie e kanë të thjeshtë

shpjegimin. Në Shqipëri nuk është ndërtuar kurrë ndonjë Taxh Mahall apo Alhambra, sepse vendit i mungonte një kryeqytet i madh islam. Në shekullin XVI, ndërsa arkitektura osmane njihnte zenitin e vet, bashkësitë islame ishin ende fare të pakta, mungonte kështu nevoja për ndërtesa të mëdha. Vështirësia më e madhe në Shqipëri është se kanë mbijetuar vetëm fare pak monumente – 97 përqind janë shkatërruar. Ndërtesa si ajo e Xhamisë së Mirahorit në Korçë, Xhamia e Sulltan Sulejmanit në Vlorë, apo Xhamia e Plumbit në Berat janë relativisht të vogla, por u përkasin shembujve më të shkëlqyer të arkitekturës klasike osmane, për nga raportet, elementet ornamentale dhe masoneria e mrekullueshme. Vetëm pak kilometra jashtë kufirit të sotëm krejtësisht artificial, në qytetin e Prizrenit qëndron një prej xhamive më të mrekullueshme dhe më hijerënda në të gjithë Ballkanin, ndërtuar më 1615: Xhamia e vezirit Sofu Sinan Pasha, një shqiptar i lindur në qarkun e afërt të Lumës. Gjatë kësaj kohe, Prizreni ishte një qendër e madhe, e banuar nga një shumicë dërrmuese myslimane dhe e pajisur me disa xhami të mëdha. Më 1573, sanxhakbeu i Shkodrës, Gazi Mehmed Beu, ndërtoi një xhami të madhe me kupolë, një medrese të madhe, një bibliotekë, një shkollë fillore (mektep), një tyrbe modeste për veten e tij dhe një hamam të madh të dyfishtë. Shumica e këtyre ndërtesave ruhen ende. Kur soditet nga brenda, kupola e ndërtesës krijon një ndjesi sikur dikush të tërheq drejt sferash të larta; duket sikur "bie lart", aq të bukura i ka raportet hapësira e

saj e brendshme.

Shtoj se kompleksi i ndërtesave përreth Xhamisë së Plumbit në Berat ka qenë dikur qendra e një kompleksi të madh shoqëror, fetar dhe arsimor (kulliye), i cili përbëhej nga një xhami, medrese, hamam, një imaret në të cilin ushqeheshin falas udhëtarët dhe të varfrit, një shkollë fillore dhe një rrugë e gjatë me dyqane e cila e lidhte kompleksin me qytetin e vjetër mbi kodër. Në mesin e shekullit XVI, ky përbënte një investim vërtet të madh. Sot ruhet vetëm një fragment prej tij.

Arti i mirë e pasqyron vetvetiu situatën e një zonë në një moment të caktuar. Ai i tregon influencat e ndryshme ndaj të cilave është ekspozuar. Është pasqyrë e historisë. Arkitektura islame shqiptare e pasqyron më së miri vendin e Shqipërisë në histori: në udhëkryqet e qytetërimeve lindore dhe perëndimore. Është pikërisht kjo arsyeja pse duhet të vajtjmë dhe të pendohemi për shkatërrimin e trashëgimisë së veçantë shqiptare dhe të tregohemi më të kujdesshëm me shembujt e saj të paktë të mbijetues.

Studimi im duhet parë si një hap për të mundësuar njohjen e trashëgimisë islame në Shqipëri thujse krejtësisht e panjohur deri më tash. Duhet kuptuar gjithashtu si një përpjekje për të korrigjuar konceptet e gabuara, të dëmshme për mbarëvajtjen e marrëdhënieve midis popujve të ndryshëm të Ballkanit dhe si një përpjekje për të dhënë një panoramë më realiste të historisë gjatë epokës osmane. Por, edhe për të zgjuar interesin e botës perëndimore për historinë shqiptare dhe pasuritë e saj kulturore.



# Si arriti ta sundojë botën, njeriu modern?



Nga: Jonathan KENNEDY, profesor në Londër, autor i librit Patogjeneza: Si e krijuan mikrobet historinë / *The Guardian* (titulli: *Scientists have discovered a 50,000-year-old herpes virus – and perhaps how modern humans came to rule the world*)

Përkthimi: Agron SHALA / Telegrafi.com

Më pak se një dekadë më parë, antropologu amerikan James C Scott i përshkroi sëmundjet infektive si “heshtja më e zhurmshme” në të dosjet parahistorike arkeologjike. Epidemitë duhet të kenë shkatërruar shoqëritë njerëzore në të kaluarën e largët dhe të kenë ndryshuar rrjedhën e historisë, por, ankohej Scotti, artefaktet e lëna nuk zbulojnë asgjë për këtë.

Gjatë viteve të fundit, heshtja u thyje nga kërkimet pioniere që analizojnë ADN-në mikrobiale e cila u nxor nga skeletet shumë të vjetra të njeriut. Shembulli i fundit i kësaj është studimi novator i cili identifikoi tri viruse në kockat 50 mijë vjet të vjetra të Neandertalit. Këta patogjenë ende i prekin njerëzit modernë: Adenovirusi, Herpesvirusi dhe Papillomavirusi shkaktojnë gripin, ethet e buzës dhe respektivisht lythet gjenitale dhe kancerin. Zbulimi mund të na ndihmojë të zgjidhim misterin më të madh të epokës së Paleolitit: çfarë e shkaktoi zhdukjen e Neandertalëve.

Përparimet e fundit në teknologjinë e përdorur për nxjerrjen dhe analizimin e ADN-së së lashtë, na kanë dhënë njohuri të jashtëzakonshme për botën e lashtë.

Me përjashtim të udhëtimit në kohë, është e vështirë të imagjinohet teknologjia aq e aftë për të ndryshuar kaq thellë kuptimin tonë për parahistorinë.

Zhvillimet e para të mëdha në revolucionin e lashtë të ADN-së erdhën nga materiali gjenetik njerëzor. Studimi i cili analizoi ADN-në nga vendet e varrimit në të gjithë Britaninë, zbuloi se Stounhenxhi u ndërtua nga fermerët me flokë të errëta, me ten më të rreshkët me origjinë nga Turqia e sotme dhe se pasardhësit e tyre vdiqën disa shekuj pasi u ngritën megalitët.

Kur një ekip i udhëhequr nga Svante Pääbo – laureat i Nobelit – renditi gjenomin e Neandertalit, kuptuan se njerëzit modernë me prejardhje evropiane, aziatike ose vendase amerikane, trashëguan rreth dy përqind të geneve të veta nga Neandertalët. Më pas, gjatë pandemisë, u bë e qartë se disa variante të geneve të Neandertalit, të cilat janë veçanërisht të zakonshme në mesin e aziatikëve jugorë, ndikuan në reagimin imun ndaj koronavirusit të ri, duke i bërë bartësit shumë më të prirë për t'u sëmurë rëndë dhe për të vdekur. Është e habitshme të mendosh se si takimet ndërmjet specieve që ndodhën dhjetëra mijëra vjet më parë, ndikojnë në shëndetin e njerëzve që jetojnë sot.

Kur shkencëtarët e nxjerrin ADN-në e njeriut nga skeletet njerëzore, ata gjithashtu marrin gjurmë të mikrobeve që gjendeshin në rrjedhën e gjakut në kohën e vdekjes. Disa nga kërkimet më interesante në këtë fushë fokusohen te Jersinia Pestisi, te bakteret përgjegjëse për murtajën. Jo shumë

kohë më parë, provat më të vjetra të saj erdhën nga mesi i shekullit XIV, kur Vdekja e Zezë vrau rreth 60 përqind të popullsisë së Evropës.

Tani e dimë se murtaja shkoi shumë më larg. Mes katër mijë dhe pesë mijë vjet më parë ishte përhapur në të gjithë Evropën dhe Azinë, duke përfshirë – siç tregoi studimi i fundit – Somersetin dhe Kumbriën. Rreth kësaj kohe, popullsia e Evropës veriperëndimore ra me 60 përqind. Ka të ngjarë që “vdekja e zezë neolitike” të ketë kontribuar në përmbysjen demografike e cila përkoi me zhdukjen fermerëve që ndërtuan Stounhenxhin në Britani dhe me ardhjen e një grupi tjetër i cili kontribuoi më shumë se gjithçka tjetër në ADN-në e Britanisë moderne.

ADN-ja e lashtë e mikroorganizmave ofron gjithashtu njohuri interesante për jetën private të paraardhësve tanë të largët.

Shkencëtarët kanë gjetur Metanobrevibakter Oralisin – një organizëm i ngjashëm me bakteret i cili lidhet me sëmundjen e mishrave të dhëmbëve të njerëzit modernë – në pllakën e kalcifikuar në dhëmbët 50 mijë vjet të vjetër të Neandertalit. Duke krahasuar llojin parahistorik me atë bashkëkohor, studiuesit llogaritën se paraardhësi i tyre i fundit i përbashkët ka jetuar rreth 120 mijë vjet më parë. Meqenëse kjo është disa qindra mijëvjeçarë pasi Neandertalët dhe Homo Sapiens u ndanë, mikrobi duhet të jetë transmetuar midis specieve. Mënyra më e mundshme se si ndodhi kjo ishte përmes puthjeve dhe përqafimeve mes specieve.

Teknikisht është gjë sfiduese për të

nxjerr dhe analizuar ADN-në virale nga kockat e lashtë. Duke qenë se viruset janë shumë më të vegjël se bakteret, ato përmbajnë më pak materiale gjenetike dhe për shkak se janë më pak të fortë, ato më shpejt degradohen. Kjo e bën tërheqës lajmin e fundit se shkencëtarët kanë sekuecuar ADN-në virale që është 50 mijë vjet e vjetër.

Derisa zbulimi se Neandertalët u infektuan nga Adenovirusi, Herpesvirusi dhe Papillomavirusi nuk do të ndryshojë në vetvete njohurinë tonë për të kaluarën e largët, kjo nënkupton zgjidhjen e misterit të madh të epokës së Paleolitit.

Deri rreth 70 mijë vjet më parë, Homo Sapiens jetonte në Afrikë, ndërsa Neandertalët banonin në Euroazinë perëndimore. Pastaj, gjithçka ndryshoi. Paraardhësit tanë migruan drejt veriut, duke u përhapur shpejt në pjesën më të madhe të botës. Jo shumë kohë më vonë, Neandertalët u zhdukën.

Që nga fundi i shekullit XIX, kur zoologu gjerman Ernst Haeckel propozoi t'i quante Neandertalët si Homo Stupidus – për t'i dalluar nga Homo Sapiens (njeri i mençur) – shpjegimi mbizotërues për këtë transformim është se paraardhësit tanë ia kalonin specieve të tjera njerëzore duke përdorur aftësitë e veta superiore njohëse. Megjithatë, ky argument është bërë gjithnjë e më i paqëndrueshëm, kjo falë provave të shtuara se Neandertalët ishin të aftë për të gjitha llojet e sjelljeve të sofistikuar, duke përfshirë varrosjen e të vdekurve të tyre, pikturimin e mureve të shpellave, përdorimin e bimëve mjekësore dhe lundrimin midis

ishujve të Mesdheut.

Zbulimi i viruseve 50 mijë vjet të vjetër tregon shpjegimin alternativ për vdekjen e Neandertalëve: sëmundjet infektive vdekjeprurëse të bartura nga Homo Sapiens. Duke qenë të ndarë për më shumë se gjysmë milion vjet, të dy speciet kanë evoluar imunitetin ndaj sëmundjeve të ndryshme infektive. Kur u ndeshën me njëri-tjetrin gjatë migrimit të Homo Sapiensit nga Afrika, patogjenët që shkaktonin simptoma të padëmshme në një specie, kanë qenë vdekjeprurëse për tjetrën dhe anasjelltas.

Është e thjeshtë arsyeja se pse Homo Sapiens mbijetoi dhe Neandertalët u zhdukën. Paraardhësit tanë jetonin më afër ekuatorit. Sa më shumë energji e Diellit arrin në Tokë, jeta e bimëve është më e bollshme atje. Kjo ofron habitatin për jetë më të dendur dhe më të larmishme shtazore, e cila nga ana tjetër mbështet më shumë mikrobet të cilat janë në gjendje të kapërcejnë mbrojtjen e specieve dhe të infektojnë njerëzit. Rrjedhimisht, Homo Sapiens i Paleolitit ka bartur më shumë patogjenë vdekjeprurës sesa Neandertalët.

Revolucioni i lashtë i ADN-së jo vetëm që transformon kuptimin tonë për parahistorinë – ai gjithashtu ka implikime të rëndësishme për të tashmen. Nëse sëmundjet infektive luajtën rol kaq kritik në zhdukjen e Neandertalëve dhe në ngritjen e Homo Sapiensit drejt dominimit të botës, atëherë patogjenët janë shumë më të fuqishëm sesa kemi menduar më parë. Paraardhësit tanë, 50 mijë vjet më parë i kishin mikrobet në anën e vet, por në mund të mos kemi aq fat në të ardhmen. /Telegrafi/



# Sami Frashëri dhe persishtja

Nga: Rudina LLAZARI

“Nji komb qi lindet ka nevojë për fatosat qi desin. Por, fatosat qi desin, nuk kane ç’të bajnë në nji komb, qi i harron dhe i përbuzë”. Kështu do të shprehë drejtuesi i revistës Hylli i Dritës, At Gjon Shllaku (1907–1946), në numrin 3-4 të kësaj reviste. “Tjetërkund, njerëzit e idealit, në u mbythshin për së gjalli, nderohen për së dekuni. Ndër ne ata mbyten dy here; edhe harrohen”. Apostrofime në dukje të thjeshta, parandjenja dhe profeci që tingëlluan deri vonë si tepër të trishtat. Në mëngjesin e zymtë, të vrenjtur dhe me shi Shkodre, të 4 marsit 1946, zemrat e shkodoranëve dridhen nga breshëritë e automatikëve dhe jehonat që vinin nga Zalli i Kirit, vendi i namun ku pushkatoheshin “mekataret” e kohës së kuqe.

Nën plumbat e skuadrës ekzekutive ranë njëri pas tjetrit, trupat e shtatë të dënuarve me vdekje ndër të cilët katër ishin klerikë katolikë. At Gjon Shllaku qe njëri ndër ta. Nuk ishte hera e parë që në të zbardhur të dritës në qytet të dëgjoheshin të shtime të tilla me ushime të “xanun” si ato që bien në mish njeriu.

Në zakonin e fituar rishtazi, pushkatimet e “heretikëve” bëheshin në orët e para kur njerëzit ishin ende në shtroja. Pas pushkatimit, zakonisht trupat e të vdekurve lireshin ashtu njëri mbi tjetrin, si të ishin thasë plehu – në dispozicion të qytetarëve, për tërë ditën.

Në muzg të natës, ashtu grumbull siç ishin, hidheshin në një gropë të përbashkët që mbulohej mirë, mundësisht të mos mund të dallohej më. Ky qe fati që parandjeu në harresën e tij edhe At Gjon Shllaku. “Ne, nesër, së bashku edhe me nji koleg temin, shkumë kinse për me shëute, kah vendi i pushkatimit, me qëllim që të vërtetojmë se ku i kishin vorrue. Kurrkund shenjë grope dhe as dheu, të çuem rishtas. Ma vonë mormë vesh se gropën e kishin çele natën, afër shtratit të lumit, në zall që e mbulon lumi mbas shinave. Dheun tepricë e kishin tretë dhe gropën e kishin rrafshue me kujdes, me fundri të qytetit: teneqe, kutia zhele, në mënyre që të mos dukej shenjë dhe as gjurmë për krimin e kryer”, shprehet në kujtimet e tij për At Gjon Shllakun, Pal Duka-Gjini. (Pseudonimi letrar i At Daniel Gjeçaj).

Në Shkodër, At Gjon Shllaku njihet si një ndër më intelektualët klerik katolik. Filozof, gazetar, profesor, At Shllaku njihet edhe politikan. Në historinë e mendimit demokristian, thuhet të jetë i pari kryetar i Partisë Demokristiane Shqiptare. Madje, duket se kjo ka qenë edhe një ndër shkaqet kryesore që e çuan atë drejt fundit dhe rrokamës të pashmangshme. Regjimi nuk mund të pranonte në



rjedhën e kohës ata që ishin në oponente ideologjike me të. Le që për njerëz të tillë, si At Gjon Shllaku, ishte i mjaftueshëm fakti se qe prift dhe që bënte pjesë në një elitë të zgjedhur intelektualësh. Të vjetrit e kujtojnë shumë mirë, megjithëse ai nuk është më që nga fillim marsi i vitit 1946. Duke kujtuar takimin e parë të tij, me at Gjon Shllakun, At Zef Pllumi tregon; “Ishte një burrë i ri, rreth të tridhjetave, por i plakun para kohe. I shkurtër, i thatë, i zbehtë, me nji palë syze të zeza që i mbulonin gjysën e fytyrës që qeshte. Jo i bëshëm në trup. Më shumë i mesëm se i gjatë. Me një paraqitje të përvuajtur. Fytyrë e një frati të zakonshëm, që pamjes të jashtme nuk i jep as rëndësi dhe as peshë. I këndshëm në të folur dhe plot njerëzi. Fytyrën dhe formën e kokës karakteristike të racës ilire. Ballin të shpërvjelur dhe flokët të rrallë”.

Kështu e mbajnë mend në kujtimet e veta, ata që e njohën at Gjon Shllakun. “Dinte me u mbajt në shoqni dhe në çdo ambient a rend shoqner, ruante të pacenueshëm dinjitetin e meshtarit, zotnisë e filozofit praktikien dhe sociologut, pasurinë e nji kulture të hapët dhe të thellë. Kishte një mbamendë të fortë dhe reflektive. Lexonte shumë dhe çka lexonte, e thandronte në mendje me kollajsi të çuditshme”, thotë për të, Pal Duka-Gjini.

Njohës i shkëlqyer i filozofëve më të përmendur të kohës italiane franceze dhe gjermane, nga ku duket se ka dalë edhe një farë interesi i tij, që mbase për momentet kur u shfaq, mund të quhej i imponuar për politikën. I gatshëm për të diskutuar mbi çdo çështje të diturisë njerëzore dhe letrare. Dinte të sillej me të gjithë, pavarësisht se kishte parapëlqim intelektualët dhe të zgjuarit e kohës.

Megjithatë, fliste përzemërsisht njësoj me të gjithë. Në Shkodër kujtohet miqësia e tij me doktor Shirokën i cili, në bisedë me të, edhe kur vinte rasti përdorte terminologjinë e ngushtë të zhargoneve të shkencës humane

të njeriut.

Po kështu mbahet mirë në mend edhe një episod tjetër. Gjatë një vizite të një grupi albanologësh italianë në Shkodër, At Gjon Shllaku është i zoti i shtëpisë. Në listën që kërkohet të bëhet për një dhuratë me libra, ai vërteton të qenit njeri erudit dhe me kulturë e shije letraro-ditunore. At Gjoni në Liceun Françeskan ku jepte mësim, konsiderohej si profesori më i përgatitur. Në kohën e vet thuhej se ishte njeriu më i lartë i kulturës shqiptare.

“E kam pasë profesor në Liceun ‘Illyricum’ dhe na jepte mësim në fiziko-kimi, në frëngjisht dhe në ekonominë politike. Ishte profesori më simpantik. Në klasë na fliste për marrjen e Bastijes, që ndryshoi botën. E kuptonim na? Sigurisht që jo ...”, thotë At Zef Pllumi, në kujtimet e veta.

Në drejtimin e Hyllit të Dritës, aftësia e Padre Gjonit spikati shkëlqyeshëm. Shpejt revista u shndërrua në një forum kombëtar, me pjesëmarrje të personaliteteve më të shquara të kulturës, si; Eqrem Çabej, L. Mirdita, Kol Naraci, Franco Alkaj, Prek Kaçinari etj. Ai mblodhi rreth vetes penat më të mprehta të kohës. Në vatrën që inicioi Fishta i madh, ku u shkri platforma e një Shqipërie të lirë dhe të përparuar, u ulën në kuvend si dikur, pleqtë e kanunit dhe shkrimtarët e rinj të krishterë ose jo, por gjithmonë, adhurues të një Zotit.

Ai pranoi ide moderne e përparimtare, por pa ia shmangë parimeve kristiane e kulturës shqiptare. Në vitin 1945, intelektualët shkodoranë organizuan konferencën për krijimin e Shtëpisë të Kulturës. “U ftua edhe Padër Gjoni, gjë që ai e përqafoi me entuziazëm. Në atë konferencë që e zgjodhi Padër Gjoni kryetar nderi, ai mbajti fjalimin përurues, fjalim që do të mbetet i paharruar për auditorin e asaj dite”, thotë kështu Zef Zorba. Të gjithë e njihnin Padre Gjonin dhe ishin të bindur se më nismëtar të tillë, kultura, ekonomia dhe arti do të lulëzonin në Shqipërinë e pavarur.

Në lajtmotivin e klerikëve është e

njohur edhe jeta e martirizuar për fe dhe për atdhe. Një jetë të tillë pati edhe martiri që njihet me emrin Gjon Shllaku. I lindur në Shkodër, djep të kulturës dhe qendër të kristianizmit, ai pati emrin Kolë në pagëzim. Ende i vogël, hyri në Kolegjin Françeskan. Në tetor 1922, shugurohet prift dhe filloi jetën rregulltare, duke ndërruar edhe emrin e pagëzimit në Gjon. Diplomohet në Holandë dhe Belgjikë, në Universitetin e Levainit, ndërsa në Francë, në Universitetin e Sorbonës, ndërsa kryen edhe një kurs për gazetari, çka do të jetë një ndër synimet e tij kryesore në drejtimin e Revistës Hylli i Dritës.

Simbas traditës së françeskanizmit në Shqipëri dhe si pasojë e edukatës të fituar nga të mëdhenjtë me zhgun – Bardhi, Gjeçovi, Harapi, Fishta dhe Rrota, që ishin mësues në shpirt dhe në zemër – Padre Gjoni ndikoi te të rinjtë jo veç ndjenjat fetare, por edhe kulturën e shëndoshë dhe ndjesitë kombëtare.

Edhe atij, si etërve të Provincës Françeskane, i dha jete binomi “Për fe dhe për atdhe”. Ajo që e dallon në misionin e tij meshtarak e françeskan, është penda dhe shkrimi. Këtu dha provat e para të një zotësie të rrallë dhe të një talenti të veçantë. Shkroi pak sepse koha qe e shkurtër e aktivitetit të tij dhe rrethanat e vështira me të cilat u gjet në momentet që hyri në radhët e shkrimtareve.

Në vitin 1946, për klerikët e krishterë në Shqipëri shënohet akti i parë dramatik i asaj tragjedie e cila dalëngadalë do ta çonte kishën e këtij vendi në asgjësim të plotë të çdo shprehje të jashtme të besimit. “Çdo ditë e më tepër rëndoheshin retë e zymta, që lajmëronin stuhi e shtrëngatë ndër ne. Më kujtohet si sot trishtimi që na kishte mbulue të gjithëve dhe më ka mbet në mendje gjendja shpirtërore e Padër Gjonit – tash më takon mua, por mjerisht s’jam as i pari as i mbrami. Të lutemi që Zoti të na japë forcë dhe zemër, për të përballuar martirizimin”, thotë kështu Pal Duka-Gjini. Akuzat qenë gati. Ai ishte me ideale

demokristiane.

Sipas disa treguesve, në fund të vitit 1945 qe dukur në Shkodër, Sejfulla Malëshova. Thuhet dhe madje është e dokumentuar që ai të ketë biseduar me Padër Gjon Shllakun, për krijimin e një Partie Demokristiane. Këto ishin argumentet që u sollën në gjyqin farsë ndaj priftit të nderuar.

Një nga përkthyeset në shërbim të Enver Hoxhës, tregon se ka dëgjuar një bisedë të Hoxhës me ambasadorin jugosllav: “E mbytëm Padër Anton Harapin e me këtë kemi plagos për vdekje klerin katolik”. Sipas rrëfimit, diplomati serb i është përgjigje; “Po! Po! Por, keni ende gjallë Padër Gjon Shllakun, i cili peshon shumë. Duhet, sipas porosisë të qeverisë seme, të zhdukni Shllakun dhe të shkatërroni në kulm dhe themel çerdhen e klerit katolik në Shkodër”.

Atë e morën në shkurt të vitit 1946. E nxorën nga klasa, ndërsa u jepte mësim nxënësve. Madje, nuk kishte arritur të shkruante as temën në regjistër të klasës. Atë natë në Radio-Shkodra u dha lajmi se “Krimineli Gjon Shllaku qe kapë duke kaluar kufirin, për t’u arratisë”. Që nga ai moment, ai ndërroi sallën e mësuesit me dhomën e torturave.

“Kur ne të tjerët kryem mësimin në dhjetë minuta, në gojë të secilit kaloi fjala. E pat edhe Padër Gjoni”, tregon Pal Duka-Gjini në kujtimet e tij. Tani Padër Gjoni bashkohej me viktimat të tjera, në pritje që të nxirreshin në arenën e koloseut të Rozafës. Shtonte rreshtin e Padër Daniel Dajanit dhe të Padër Faustit, “anëtar të organizatës antipopullore, ‘Bashkimi Shqiptar’”. Mbi të binte edhe akuza e të qenit si kryetar i Partisë Demokristiane, në fillimet e saj. Në gjyq pati një avokat të guximshëm dhe tepër të përgatitur si nga ana intelektuale, ashtu dhe profesionale – Myzafer Pipën. Ky ishte ish-student i tij, e njihje personalitetin e Padër Shllakut dhe nuk e pati të zorshme edhe mbrojtjen, megjithëse pati pasoja prej tij. Sipas kujtimeve të Pal Duka-Gjinit, Myzafer Pipa ka pranuar të mbrojë Padër Gjonin dhe në një koment tha: “Shka mund të bëjë juristi, ku s’ka ligje dhe as drejtësi?! Si mund të mbrojë një njeri, në kje se në kohë, para se te provohet apo jo faji i tij, asht i dënuem”?!  
Një gjyq tragjikomik, Padër Gjoni dënohet me vdekje. Akuzat të planifikuar nga lart, paraqitën Padër Gjonin, si ideologun dhe krijuesin e Partisë Demokristiane dhe organizatorin dhe udhëheqësin e “Bashkimit Shqiptar”. Fajtor për vdekje, jo vetëm si kundërshtar regjimi, por edhe si “kriminel dhe njeri i dëmshëm për popullin dhe kombin”. Dënimi me vdekje kishte ardhur prej kohe nga Tirana zyrtare. Pas kësaj, ekzekutimi ishte një rutinë.















**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



## Shqipëria zhvillon stërvitjen e fundit, sonte përballet me Lihtenshtejnin

**STEGERSBACH, 2 QERSHOR** - Kombëtarja shqiptare e futbollit ka vijuar sipas programit seancat stërvitore në kuadër të fazës përgatitore për finale të "Euro 2024" që po zhvillohet në Stegersbach të Austrisë.

Departamenti i Komunikimit në FSHF bën me dije se mesfushori Amir Abrashi është bashkuar me grupin në stërvitje dhe ka punuar me ngarkesa më të ulëta në këtë ditë të parë. Gjendja e grupit është e mirë dhe

aktualisht nuk ka asnjë lojtar me probleme fizike. Siç është bërë me dije me parë, mbrojtësi Berat Gjimshiti është i fundit që i bashkohet grupit në Austri më datë 3 qershor. Kjo ishte seanca e fundit stërvitore para miqësore

me Lihtenshtejnit që do të luhet më 3 qershor në stadiumin "Haladas Sportcomplex" të Hungarisë, me kuqezinjtë që do të rikthehen sërish në bazën stërvitore pas kësaj sfide për të vijuar me përgatitjet.



## Vojvoda e Bekaj presin paraqitje të mirë në Oslo

### "Epoka e re"

**PRISHTINË, 2 QERSHOR** - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll ka mbajtur sot pasdite seancën e radhës stërvitore në kuadër të përgatitjeve për miqësoren kundër Norvegjisë, që zhvillohet më 5 qershor. Ekipit iu ka bashkuar edhe portieri Arijanet Muric, i cili për shkak të gjendjes jo të mirë shëndetësore ka munguar në ditët e para të grumbullimit. Ai ka marrë pjesë në stërvitjen e sotme, derisa me intensitet të plotë kanë stërvitur edhe Edon Zhegrova dhe Amir Rrahmani, të cilët një ditë më parë kishin shqetësime të vogla. Edhe në stërvitjen e sotme djemtë dardanë kanë punuar me përkushtim maksimal, përkundër temperaturave goxha të larta,

derisa përzgjedhësi Franco Foda ka vazhduar ta prezantojë filozofinë e lojës të cilën synon ta aplikojë në ndeshjet e ardhshme. Pas stërvitjes opinionet e tyre për punën e deritashme në këtë grumbullim dhe pritjet që kanë për miqësoren me Norvegjinë i dhanë Mërgim Vojvoda dhe Visar Bekaj. "Besoj që kemi treguar koncentrim deri tash sepse nuk është lehtë kur e dimë se kampionati ka përfunduar. Por stërvitjet kanë shkuar mirë, çdo lojtarë është në rregull dhe shpresoj të jenë të gjithë në dispozicion. Trajneri po mundohem me idetë e tij të përgatitemi sa më mirë. Duam që të krijojmë lojën tonë, filozofinë tonë, idetë e trajnerit për ato lojë që na vijnë në shtator. E dimë se Norvegjia është ekip i fortë fizikisht,



ka lojtarë të mirë, por duhet të luajmë lojën tonë dhe e presim me pozitivitet për fitore. Shpresoj të kemi mbështetjen e bashkatdhetarëve sepse na vyen përkrahje e tyre. Kemi nevojë për ta dhe na bëhet qejfi që të ketë sa më shumë shqiptarë", ka thënë

Vojvoda pas stërvitjes. Edhe portieri Visar Bekaj theksoi se gjatë katër ditëve kanë punuar mjaft mirë. "Në fillim kemi pasur stërvitje më intensive, kurse me afimin e ndeshjes po punojmë më shumë taktikisht. Jemi duke e analizuar mirë kundërshtarin. Është ndeshje

miqësore, por prapëseprapë e ka rëndësinë e vet dhe duhet të fokusohemi 100 përqind. Duhet të fusim në ekip mentalitet fituesi dhe shpresoj të shkojmë të bëjmë lojë të mirë atje dhe pse jo të fitojmë, pastaj të vazhdojmë në Ligën e Kombeve me fitore. Norvegjia ka lojtarë të mirë. Pika e fortë e tyre është mesfusha dhe sulmi, por në ndeshjet e fundit kanë çaluar në mbrojtje. Shpresoj se do të analizojmë deri në fund se ku i kanë pikat e dobëta dhe të dalim mirë. Po ashtu, i ftoj bashkatdhetarët që të na mbështesin sa më shumë dhe shpresoj t'i gëzojmë me fitore", ka deklaruar Bekaj. Të hënën paradite "Dardanët" e zhvillojnë stërvitjen e fundit në Kosovë, derisa më pas marrin rrugë për në Oslo.

## Vashat e Kosovës zhvilluan stërvitjen e radhës në Zagreb

**ZAGREB, 2 QERSHOR** - Përfaqësuesja e Kosovës në konkurrencën e femrave ka zhvilluar stërvitjen e radhës në Zagreb të Kroacisë. "Dardanët" ndonëse të lodhura nga udhëtimi, dolën të motivuara në fushë. Kjo është stërvitja e parafundit e Kosovës para ndeshjes kthyes ndaj Kroacisë në kuadër të kualifikimeve për Evropianin 2025. Në këtë sesion përzgjedhësja Anneli Andersen aplikoi stërvitje rigjenerues dhe komunikuese, e cila po ashtu ndikoi në rikthimin e pozitivitetit në ekip, pas humbjes me rezultat të ngushtë të pësuar në "Zahir

Pajaziti". Përzgjedhësja Andersen tha se duhet të punojnë më shumë për ndeshjen e kthyes ndaj Kroacisë. "Ne ishim të mira në ndeshjen e parë por duhet të punojmë më shumë në rikuperim dhe të pushojmë. Ne duhet të mësojmë nga ndeshja e kaluar por edhe jemi të motivuar dhe besojmë se bëmë një lojë të bukur herën e kaluar por sigurisht se duam të arrijmë më shumë sukses në ndeshjen e radhës", ka deklaruar përzgjedhësja Anneli Andersen. Kosovës i janë bashkuar edhe dy futbolliste të cilat nuk ishin të pranishme në



ndeshjen e së premtes në "Zahir Pajaziti". Vanesa Hoti dhe Modesta Uka, të cilat e kompletuan ekipin dardan. Kjo e fundit u shpreh e lumtur që pati

mundësi t'i bashkohet Kosovës, derisa pohoi se do ta japë maksimumin nga vetja: "Kur jam me Kosovën jam e sigurt në vetvete, dhe do ta jap më të mirën

time", ka thënë futbollistja Uka. Ndërsa Rrezona Ramadani e konsideron të mirë paraqitjen e Kosovës ndaj Kroacisë të premten, ndërsa pohoi se stërvitja e sotme u ka rikthyer motivin për t'u përkushtuar edhe më shumë për ndeshjen e të martës: "Vijmë pas një ndeshje të lodhshme por ekipi gjeti forcën dhe doli sot në fushë për një stërvitje të lehtë, e cila më shumë ishte motivuese dhe për të qenë gati për stërvitjen e nesërme dhe ndeshjen e të martës", pohoi Rrezona Ramadani. Stërvitjen zyrtare Kosova e zhvillon të qenën në Karlovac.

## Prishtina konfirmon largimin e Egbos



**PRISHTINË, 2 QERSHOR** - FC Prishtina ka konfirmuar largimin e trajnerit Emmanuel Egbo, të cilit i ka skaduar kontrata. Pasi dështuan të kualifikohen në Evropë, "bardhëkaltërit" kanë vendosur të

mos e vazhdojnë bashkëpunimin me trajnerin nigerian. "Falënderojmë për punën e deritanishme të kryetrajnerit, Emmanuel Egbo dhe trajnerit, Eldiano Topi me të cilët ka

përfunduar afati kohor i marrëveshjes dhe FC Prishtina, futbollistët dhe i tërë stafi u dëshiron sukses në vazhdim të karrierë. Kryetrajneri Egbo, ka udhëhequr ekipin nga fundi i

muajit tetor dhe ka regjistruar 33 ndeshje zyrtare (14 fitore, 10 barazime dhe 9 humbje, 41:25) duke u renditur të 5-të në klasifikim dhe duke arritur deri në finale të Kupës", ka njoftuar FC Prishtina.

## Mourinho prezantohet te Fenerbahçe

**Stamboll, 2 qershor** - Jose Mourinho është trajneri i ri i Fenerbahçes. Pas largimit nga Roma në janar, trajneri portugez e ka marrë drejtimin

e gjigantit turk. E në prezantim rreth 250 mijë persona e kanë ndikuar drejtpërdrejt në kanalën e youtubes. "Ju premtoj, që nga tani, unë ju

përkas juve si familje. Fanella e Fenerbahçes është sikur lëkura dhe kockat e mia. Faleminderit për dashurinë tuaj për mua. Normalisht një trajner e shih

dashurinë pas ndonjë fitoreje, por unë e shoh këtë dashuri menjëherë. Kjo është një përgjegjësi e madhe", ka deklaruar Jose Mourinho.



## Muriqi: Ndhimova sa munda, sezoni tjetër do të shkojë më mirë

**MALLORCA, 31 MAJ** - Sezoni në La Liga tashmë ka përfunduar dhe Mallorca e Vedat Muriqit arriti ta siguronte mbijetesën tek në xhiron e parafundit. E sulmuesi nga Kosova ka reaguar në rrjetet e tij sociale lidhur me edicionin e fundit. Ai foli për sezonin jo të mirë, teksa

përmendi edhe finalen e Kupës së Mbretit që e humbi ndaj Athletic Bilbaos. "Ne përfundojmë një sezon plot emocione të ndryshme. Shumë i lumtur që kam arritur qëndrueshmërinë dhe që Mallorca është në kategorinë e parë edhe për një sezon tjetër,

megjithëse do të donim ta arrinim duke ju bërë të vuani më pak. Lëndimi im më ka shënuar një pjesë të madhe të sezonit, i cili, në nivel personal, nuk ka qenë ajo që kam dashur, por gjithmonë jam përpjekur t'i bashkohem skuadrës dhe të jap gjithçka për

këtë klub dhe këtë simbol. Nuk mund t'i them lamtumirë sezonit pa veçuar finalen e kupës në Sevilje. Ajo që përjetuam atë ditë ishte unike dhe duhet të jemi krenarë që arritëm në finale. Tani është koha për të pushuar, por me të vërtetë dua që sezoni i



## Martin Nemeć, përzgjedhës i ri i Kosovës në volejboll

**PRISHTINË, 31 MAJ** - Federata e Volejbollit e Kosovës e ka emëruar sllovakun Martin Nemeć përzgjedhës të ri të Përfaqësueses së Kosovës në Volejboll. FVK-ja ka bërë një hap të rëndësishëm për përfundimin e ekipit përfaqësues dhe rritjen e nivelit të volejbollit në vend. Me një karrierë të gjatë dhe të suksesshme si lojtar dhe trajner, Nemeć sjell me vete një përvojë të gjerë ndërkombëtare. Ai ka luajtur për disa prej ekipeve më të mira në Evropë dhe ka trajnuar ekipe në ligat më të njohura të kontinentit. Përveç kësaj, ai është njohur për aftësitë e tij taktike dhe për qasjen e tij inovative ndaj stërvitjes dhe zhvillimit të lojtarëve. "Jam i nderuar dhe i emocionuar që jam emëruar përzgjedhës i Kombëtares së Kosovës në Volejboll. E shoh një potencial të madh në këtë ekip dhe jam i përkushtuar të punoj fort për t'i



arritur sukseset që meriton ky vend", ka thënë Nemeć pas emërimit. Ky emërim shënon një hap të ri për zhvillimin e sportit të volejbollit në Kosovë dhe

Federata shpreson që me përvojën dhe udhëheqjen e Nemeć, Kosova do të arrijë rezultate të shkëlqyera në garat e ardhshme ndërkombëtare.

## Dallasi shpallet kampion në Konferencën e Perëndimit

**MINNEAPOLIS, 31 MAJ** - Dallas Mavericksi u kualifikua në finalen e madhe të NBA-s pasi mposhti Minnesota Timberwolvesin me rezultat 124:103, duke fituar me rezultat të përgjithshëm 4-1 finalen e Konferencës Perëndimore. Dallasi pati një fillim fenomenal në këtë ndeshje, e cila u luajt në "Target Center" në Minneapolis dhe tashmë pas çerekut të parë kishte një avantazh prej 16 pikësh. Vlen të theksohet se sloveni i shkëlqyer Luka Donçiq shënoi 20 pikë në çerekun e parë. Minnesota ishte e tronditur, asgjë nuk po shkonte siç duhej, kështu që deficieti vetëm sa u rrit dhe pjesa e parë përfundoi me rezultatin 69:40 për Dallasin. Skuadra vendase tregoi dhëmbët në pjesën e dytë në të cilën ishin shumë më mirë, por e gjithë kjo nuk mjaftoi për asgjë. Në fund të lojës



ata arritën ta zbusnin sikletin, ndërsa Dallasi mund të fillonte të festonte pas fitores 123:103. Mavericksi u çua në finalen e madhe nga Dončić dhe Kyrie Irving. Të dy shënuan nga 36 pikë, ndërsa sloveni shtoi edhe 10 kërcime. Karl-

Anthony Towns ishte i vetmi në formë të Minnesota me 28 pikë dhe 12 kërcime. Dallasi do të luajë kundër Boston Celticsit në finalen e madhe të NBA-s dhe ndeshja e parë e serisë do të luhet mëngjesin e së premtes së ardhshme.

### SHKURT

#### Zhegrova: Ka ardhur momenti të transferohem në klub të madh

Edon Zhegrova zhvilloi sezonin e jetës në Francë, ku me 12 gola dhe 10 asistime ishte një nga lojtarët më të mirë të Lille. Këto shifra dhe paraqitja e tij pritet ta largojnë Zhegrovën gjatë verës nga klubi francez. Një fakt që e ka pranuar edhe vetë lojtari nga Kosova, duke shprehur dëshirën e tij për t'u transferuar në një ekip më të madh. "Mendoj se kam dhënë më të mirën time te Lille. Mendoj se tani ka ardhur momenti të transferohem në një klub më të madh", u shpreh Zhegrova për Oxygen. Zhegrova u transferua te Lille në janar të 2022-s nga Bazeli për 7 milionë euro, por tani vlera e kartonit të tij është dyfishuar.

#### Mourinho arrin marrëveshje me Fenerbahçen

Jose Mourinho do të rikthehet të punojë si trajner. Tekniku portugez raportohet se ka arritur një marrëveshje me gjigantin turk Fenerbahçe. Është gazetari i njohur, Gianluca Di Marzio, që raporton se Mourinho ka arritur marrëveshje dyvjeçare me Fenerbahçen. Portugezi është i papunë qëkur u largua nga skuadra e Romës, të cilën e dërgoi në dy finale radhazi, atë të Ligës së Konferencës dhe atë të Ligës së Evropës. Portugezi ka drejtuar edhe Chelsea, Porton, Manchester Unitedin, Tottenham Hotspurin dhe Real Madridin.

#### Gasperini: Dua Realin në finalen e Superkupës së Evropës

"Në finalen e Ligës së Kampionëve ne mbështesim Real Madridin". Kështu shprehet Gian Piero Gasperini, trajneri i Atalantës, për ndeshjen mes spanjollëve të Ancelottit dhe Borussia Dortmundit. "Nuk kemi asgjë kundër Borussia Dortmundit. Në këtë moment jemi përballur edhe vite më parë në Evropa Ligë, por finalen e Superkupës së Evropës në Varshavë më 14 gusht me Real Madridin do të ishte më prestigjiozi i mundshëm", ka thënë Gasperini. Me një sy në Superkupën e Evropës, Gasperini praktikisht i ka shlyer rezervat për të ardhmen e tij, e cila, pavarësisht prej miqësive të shumta, do të vazhdojë të jetë në Atalantë. "Me fitoren në Evropë kam marrë oferta edhe nga jashtë, por jo, nuk ka më kohë. Edhe tani kam pasur një ofertë të bukur nga Premierë Liga, diçka e fundit, por Italia më pëlqen shumë" ka deklaruar Gasperini.

#### Cavani pensionohet nga Kombëtarja e Uruguait

Sulmuesi Edinson Cavani nuk do të grumbullohet më me Kombëtaren e Uruguait. Sulmuesi lajmëroi së fundmi tërheqjen nga ekipi kombëtar me idenë për t'u fokusuar tashmë vetëm tek Boca Juniorsi në Argjentinë. 37-vjeçari debutoi me Uruguain në vitin 2008, teksa është edhe golashënuesi i dytë më i mirë në historinë e kombëtares. Në njoftimin e tij për tërheqjen nga Uruguai, Cavani falënderoi ekipin kombëtar për të gjithë rrugëtimin dhe për atë që i kishte mësuar gjatë karrierës, ndërsa theksoi se tashmë kombëtarja e tij do të kishte një tifoz më shumë në tribuna.

## Shefi i Ferrarit: Fitorja në Montekarlo do ta rrisë besimin e ekipit

Ferrari duket se ka rilindur këtë sezon, me dy fitore në 8 garat e para sezonale në Formula 1. Suksesi në pistën qytetase të Montekarlos nga Charles Leclerc shihet si një motivim për "kokëkuqen", që synon të bëjë një paraqitje të mirë edhe pas 10

ditësh në Kanada. Shefi i Ferrarit, Frederic Vasseur, njeriu që ka vënë rregull të skuadra, ka thënë: "Në tri garat e fundit ne kemi qenë gjithmonë brenda një të dhjetës së sekondës nga rivalët. Është një kampionat emocionues, me gjashtë makina

që mund të luftojnë për pole çdoherë, kështu që ne duhet të qëndrojmë të fokusuar në ngjarjet individuale që na presin. Unë dua që ekipi të vazhdojë të përmirësohet në çdo drejtim. Edhe nëse po ecim mirë, ky është vetëm fillimi. Unë insisto

gjithmonë në të njëjtin mesazh. Të gjithë bëjnë një ndryshim në performancën e Ferrarit në pistë. Të gjithë janë përgjegjës për rezultatit si kur gjërat shkojnë keq ashtu edhe kur fitojmë. Fitorja e Leclerc ishte e veçantë, sepse Charles e kishte prituri për një

kohë të gjatë dhe kishte humbur disa mundësi në të kaluarën. Fitorja në shtëpinë e tij do t'i jap atij më shumë besim te vetja dhe do ta rrisë besimin e ekipit. Morali është i lartë e po shtyjmë në drejtimin e duhur", ka thënë drejtori i "kokëkuqes".

**NJOFTIM**

Njotojmë të gjithë klientët se "XHEMA-Z", Sh.P.K, nga Mitrovica ka marre vendim te shuaje biznesin me NUI: 810195736 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës se Likuidimit. Njoftohen te gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitore me kete kompani që te paragiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes ne gazete.

**OBAVESTENJE**

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "XHEMA-Z", d.o.o., od Mitrovica donelo odluku o prestani rada sa bisnisom NUI: 810195736 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavijivanja o novine.

**ANNOUNCEMENT**

We inform all clients that "Pro Edit", L.L.C, has taken the decision to quit its business with NUI: "XHEMA-Z", from Mitrovica, the appointed a liquidator who is going to oversee the liquidation process. All clients who have creditor - debtor accounts with this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.



Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"  
Fakulteti Juridik

Rr. Agim Ramadani, nr. 14, 10000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +381-38-229063

URL: <http://www.uni-pr.edu>

Në bazë të nenit 127 al.1 të statutit të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", neni 17 al. 2 dhe 4, të rregullores mbi studimet shkencore pasdiplomike dhe vendimit nr.. 9/21 nga Mbledhja e Këshillit të Fakultetit Juridik, të datës 12.03.2024, si dhe vendimit për ratifikimin nga Senati i UP, nr. 1/472, datë 14.05. 2024, kandidatit **Ma.sc. Nur Çeku, PhD. cand**, i është lejuar mbrojtja publike e disertacionit të doktoratës, andaj mbi bazën e dispozitave të më lartë cekura bëjmë këtë

**NJOFTIM**

Me të cilin njoftojmë të gjithë të interesuarit, se me datën 14.06.2024, me fillim në ora 14:00, në sallë të mbledhjeve të Fakultetit Juridik të UP-së, kandidati për fitim të titullit doktor i shkencave juridike-nga fusha kushtetuese- administrative , **Ma.sc. Nur Çeku** e bënë mbrojtjen publike të disertacionit me titull: **"Efekti i mbikëqyrjes parlamentare në llogaridhënien dhe sundimin e ligjit në Kosovë"**, para komisionit profesional në përbërje:

1. Prof. Dr. Visar Morina, (Kryetar) Fakulteti Juridik,
2. Prof. Asoc. Dr. Gjyljeta Mushkolaj (Anëtar ) Fakulteti Juridik,
3. Prof. Dr. Bedri Peci (Anëtar) Fakulteti Juridik,
4. Prof.Asoc. Dr. Murat Jashari (Anëtar) Fakulteti Juridik,
5. Prof. Asoc. Dr. Blerton Sinani( Anëtar i jashtëm )- Fakulteti i Drejtësisë i Universitetit të Evropës Juglindore.

Mentor i kandidatit:  
Prof. Dr. Arsim Bajrami

Prishtinë  
31.05.2024

**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Cjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



[www.facebook.com/gjejpuneshpejte](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejte)

**RESTAURANT****SWISS****TAVERNA**

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

- Agron Syla shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "Hasan Prishtinë" ish shkolla e mesme Qendra Ekonomike Shkollore.

-Art Knusi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11. sh.m. Ekonomike "Kadri Kusari" Gjakovë.

-Leona Kujtim Memia nga Tropoja R. Shqipërisë shpall të pavlefshme diplomën e U. "Fehmi Agani" Gjakovë programi Gjuhë Shqipe dhe Letërsi me nr. 266 dt.22.10.2020.

-Gresë Dervishi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 1.2.3.4 të sh.m. Mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.



ROYAL CROWN  
**RC**  
cola

**ANNOUNCING THE 2017  
QUALITY & SALES AWARDS**

**Quality & Sales Award Recipients**  
[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

**RC**  
cola  
Columbus, Georgia, USA  
Since 1908

**RC**  
cola  
Columbus, Georgia, USA  
Since 1908  
0.5L



# TRADITË QË NGA

# 1992

